



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCEVE**  
**MINISTRI**

**U D H Ë Z I M**

**Nr. 17/2, Datë. 05. 11. 2008**

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR.17 , DATË 13.05.2008 “PËR  
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”.**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të neneve 35 e 58 të ligjit Nr. 7928 date 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar”, Ministri i Financave:

**UDHËZON :**

Në Udhëzimin nr.17. datë 13.05.2008 « Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar», në pikën 9.4 “Furnizimi i karburanteve”, bëhen shtesat si më poshtë :

1. Pas gërmës b) “Detyrime të palëve”, shtohet gërmat c), ç) d) dhe dh), me përmbajtje si më poshtë:

c) Furnizimi i karburantit ndërmjet shoqërive të tregtimit me shumicë (shoqërive anonime), konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës dhe vlera e tatueshme e tij, përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Vlera e tatueshme e furnizimeve të kryera nga shoqëria e tregtimit me shumicë e furnizuar në këtë mënyrë, për shoqëritë e tregtimit me pakicë, si dhe e këtyre të fundit për klientët konsumatorë finalë, përcaktohet duke marrë për bazë çmimin e shitjes me pakicë, siç përcaktohet në gërmën a) më lart.

ç) Kur karburanti i furnizuar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë është i destinuar të konsumohet për veprimtarinë ekonomike të konsumatorëve të medhenj, për nevoja të institucioneve apo enteve publike, si dhe për eksport, vlera e tatueshme e furnizimit, përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

d) Kur karburanti furnizohet me tollona, në momentin e dorëzimit të tollonave, apo nëse më parë është bërë ndonjë pagesë, shoqëria furnizuese lëshon faturë tatimore për përfituesin e tollonave dhe lëshimi i faturës, përbën momentin e furnizimit.

Vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga

shoqëria furnizuese.

Stacionet e shitjes me pakicë, në fund të muajit regjistrojnë shitjet me tollona në mënyrë që të evidentohen qartë sasi të shitura për llogari të secilës shoqëri lëshuese të tollonave. Shumat e tollonave hidhen në fund të muajit në një faturë tatimore përmbledhëse, e cila paraqitet në librin e shitjes, por pa efekte (pasi deklarimi është bërë më parë në momentin e dorëzimit të tollonave), pra ato deklarohen me storno.

Si provë e këtij furnizimi shërben kontrata e lidhur midis shoqërisë furnizuese me tollona dhe klientit në të cilën përveç të tjerash, paraqitet edhe sasia dhe çmimi i karburantit të furnizuar.”

dh) Klientëve, persona të tatueshëm, të furnizuar nga shoqëritë e shitjes me pakicë, apo ato të shitjes me shumicë të karburanteve, u lind e drejta e kreditimit të TVSH-së të paraqitur në faturat tatimore të lëshuara prej këtyre furnizuesve, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**Ridvan BODE**

**MINISTER**